



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
ADMINISTRATORI

Nr. 2395 Prot.

Tiranë, më 14 / 09 / 2024

**NJOFTIM**  
**PËR APLIKIM PËR EKSPERT TË JASHTËM INXHINIER NDËRTIMI**  
(angazhim me kontratë shërbimi)

Universiteti i Sporteve të Tiranës, në zbatim të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në kuadër të tenderimit me objekt: Mbikqyrje (Supervizim për objektin “Rikonstruksion e Fushës Futbollit, Pistës Atletikës dhe rrethimi në Universitetin e Sporteve të Tiranës”) të Autoritetit Kontraktor, Universiteti i Sporteve të Tiranës, për të qenë pjesë e Grupeve të Punës, kërkohet 1 (një) Inxhinjer i fushës së Inxhinjerisë së Ndërtimit, si ekspert i jashtëm (të angazhuar me kontratë shërbimi).

Eksperti duhet të plotësojë këto kriteret:

1. Të ketë përfunduar studimet universitare ose pasuniversitare sipas fushës së kërkuar, (Inxhinier Ndërtimi).
2. Të ketë eksperiencë pune mbi 3 (tre) vite.
3. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

Kandidatët që aplikojnë, duhet të dorëzojnë brenda datës 23.09.2024, në zyrën e Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, këto dokumenta:

- Kërkesë me shkrim për aplikim;
- Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard (europass);
- Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
- Kopje e noterizuar e diplomës/diplomave dhe njehsimin e tyre në MAS (për diplomat e marra jashtë vendit);
- Kopje e noterizuar e liçencës në fushën e Inxhinierisë së ndërtimit;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore, vetëdeklarim sipas formës së kërkuar nga ligji;
- Vetëdeklarim mbi parandalimin e konfliktit të interesit.

Mënyra e vlerësimit: Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje.

ADMINISTRATORI

Haxhirete Sulaj

